

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 6
03.03.2014

NR. VENDIMI 25
10.12.2014

V E N D I M
“N E E M E R T E R E P U B L I K E S”

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda, Tirane, me trup gjykues te perbere nga :

Fran	PRENDI	- K/Seance
Dritan	HALLUNAJ	- Anetar
Klodian	KURUSHI	- Anetar

Asistuar nga sekretare **Ermira TERBUNI**, sot me date **10.12.2014**, perfundoj se gjykuari ne seance gjyqesore publike, ceshtjen Nr.06 akti, date 03.03.2014 regjistrimi, qe i perket :

KERKUES :

- 1. A.Sh.**, i biri i A. dhe i R., i datëlindjes xxx, lindur në xxx-xxx dhe banues në Rrugën "xxx", xxx, me zotësi të plotë për të vepruar, me shtetesi shqiptare. Perfaqesuar ne gjykim nga mbrojtësit e zgjedhur prej tije me prokuren e pergjithshme nr.xxx rep., nr.xxx kol., date xxx, av.Sh.D. dhe av.S.K., avokat prane Dhomes se Avokatise xxx.
- 2. S.Sh.**, i biri i A. dhe i R., i datëlindjes xxx, lindur në xxx-xxx dhe banues në Rrugën "xxx", xxx, me zotësi të plotë për të vepruar, me shtetesi shqiptare. Perfaqesuar ne gjykim nga mbrojtësit e zgjedhur prej tije me prokuren e pergjithshme nr.xxx rep., nr.xxx kol., date xxx, av.Sh.D. dhe av.S.K., avokat prane Dhomes se Avokatise xxx.

PERSONA TE TRETE :

- 1. C.M.,** i biri i A. dhe i T., i datëlindjes xxx, lindur në fshatin xxx-xxx dhe banues në Rrugën "xxx", xxx, Pallati Nr.xx, xxx, me zotësi të plotë për të vepruar, me shtetesi shqiptare. Perfaqesuar ne gjykim nga mbrojtësit e zgjedhur prej tij me prokuren e pergjithshme nr.xxx rep., nr.xxx kol., date xxx, av.Sh.D. dhe av.S.K., avokat prane Dhomes se Avokatise xxx.
- 2. F.Z.,** i biri i Sh. dhe i H., i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në xxx-xxx, me zotësi të plotë për të vepruar, me shtetesi shqiptare. Perfaqesuar ne gjykim nga mbrojtësit e zgjedhur prej tije me prokuren e pergjithshme nr.xxx rep., nr.xxx kol., date xxx, av.Sh.D. dhe av.S.K., avokat prane Dhomes se Avokatise xxx.
- 3. N.M.,** i biri i A. dhe i T., i datëlindjes xxx, lindur në fshatin xxx-xxx dhe banues në lagjen xxx, qyteti xxx, me zotësi të plotë për të vepruar, me shtetesi shqiptare. Perfaqesuar ne gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur prej tije me prokuren e posaçme nr.xxx rep., nr.xxx kol., date xxx, av.Sh.D., avokat prane Dhomes se Avokatise xxx.
- 4. N.O.,** e bija e S. dhe e Z., e datëlindjes xxx, lindur ne xxx xxx dhe banuese në xxx, me zotësi të plotë për të vepruar, gjykuar ne mungese pasi ka refuzuar te paraqitet ne gjykim, përfaqësuar ne gjykimin e meparshem sipas Prokurës së Posaçme Nr.xxx Rep. Nr.xxx Kol. datë xxx, nga përfaqësuesi i posaçëm, Av. Sh.D. me Nr. Liçense xxx, anëtar i Dhomës së Avokatisë xxx.
- 5. A.H.,** i biri i S. dhe i F., i datëlindjes xxx, lindur në xxx xxx dhe banues në xxx, me zotësi të plotë për të vepruar, me shtetesi shqiptare. Perfaqesuar ne gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur prej tije me prokuren e posaçme nr.xxx rep., nr.xxx kol., date xxx, av.Sh.D., avokat prane Dhomes se Avokatise xxx.
- 6. S.M.,** i biri i A. dhe T., i datëlindjes xxx, lindur në fshatin xxx xxx dhe banues në Lagjen "xxx" xxx, me zotësi të plotë për të vepruar, me shtetesi shqiptare. Perfaqesuar ne gjykim nga mbrojtësi i zgjedhur prej tije me prokuren e posaçme nr.xxx rep., nr.xxx kol., date xxx, av.Sh.D., avokat prane Dhomes se Avokatise xxx.
- 7. Z.Z.,** i biri i Sh. dhe i H., i datëlindjes xxx, lindur dhe banues në fshatin xxx-xxx, me zotësi të plotë për të vepruar, me shtetesi shqiptare. Perfaqesuar ne gjykim nga mbrojtësit

e zgjedhur prej tije me prokuren e pergjithshme nr.xxx rep., nr.xxx kol., date xxx, av.Sh.D. dhe av.S.K., avokat prane Dhomes se Avokatise xxx.

8. **S.G.**, i biri i **A.**, i datëlindjes xxx, lindur në xxx xxx dhe banues në xxx, me zotësi të plotë për të vepruar, me shtetesi shqiptare. Perfaqesuar ne gjykim nga mbrojtësit e zgjedhur prej tije me prokuren e pergjithshme nr.xxx rep., nr.xxx kol., date xxx, av.Sh.D. dhe av.S.K., avokat prane Dhomes se Avokatise xxx.

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria Prane Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane, perfaqesuar nga prokurori **Besnik Muçi**.

ME OBJEKT : Rishikimin e vendimit nr.xx, date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane, lene ne fuqi me vendimin nr.xx, date xxx te Gjykates se Apelit Per Krime te Renda Tirane si dhe vendimin nr.xxx, date xxx, te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte.

BAZA LIGJORE :

- Neni 449, 450/a/e/c, 452/1/2, 453/1 te Kodit te Procedures Penale.
- Neni 3/1/d, 5/1/2, 24/2/b te Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”.

Gjykata e Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane, si perfundoj se shqyrtuari ne seancen e sotme gjyqesore kerkesen me nr.06 akti, si degjoj bisedimet perfundimtare te paleve, te cilat kerkuan;

Per palen kerkuese dhe personat e trete, Avokatet Sh.D. e S.K., pranimin e kerkeses per rishikim, rishikimin e vendimit nr.xx, date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane duke vendosur rrezimin e kerkeses se prokurorise dhe heqjen e mases se konfiskimit per pasurite;

- *1. Llogarisë bankare në lekë, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh. me gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xxx) xxx (xxx) lekë.*
- *2. Llogarisë bankare në dollarë amerikanë, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh., me depozitim fillestar xxx (xxx) dollarë amerikanë dhe gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xxx) xxx (xxx) dollarë amerikanë.*
- *3. Llogarisë bankare në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh., me gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xxx) xxx (xxx) euro.*
- *4. Llogarisë në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh., me gjendje në momentin e verifikimit (datë xxx), xxx xxx) euro dhe, gjendje aktuale xxx (xxx) euro.*
- *5. Llogarisë bankare në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, në emër të A.Sh., me numur bazë të klientit xxx dhe numur depozite me afat xxx, me gjendje në momentin e verifikimit (datë xxx), xxx (xxx) euro dhe gjendje aktuale xxx (xxx) euro.*
- *6. Llogarisë bankare në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të S.Sh. dhe F.Z., në shumën prej xxx (xxx) euro, me gjendje aktuale në momentin e verifikimit (datë xxx), xxx (xxx) euro.*
- *7. Llogarisë bankare në euro, në Banken Intesa San Paolxxxxo, Dega xxx me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të C.M., me një transaksion të vetëm, po në këtë datë, në shumën xxx (xxx) euro.*

Prokurori Besnik Muçi ne perfundim kerkoj pushimin e gjykimit per konfiskimin e pasurive te shtetasve A.Sh., C.M. dhe F.Z., kthimin e pasurive te konfiskuara me vendimin nr.xx, date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane, lene ne fuqi me vendimin nr.xx, date xxx te Gjykates se Apelit Per Krime te Renda Tirane si dhe vendimin nr.xxx te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte, detyrimin e shtetasve A.Sh., S.Sh., C.M. dhe F.Z. per te njoftuar per nje periudhe prej pese vjetesh ne Policine Taimore akte te zoterimit, blerjes ose pagesave te kryera, te pagesave te marra, detyrave profesionale, te administrimit ose kujdestarise dhe akte apo kontrata te tjera jo me te vogla se 2 milion leke;

Gykata, si shqyrtoj e vlerësoj ne teresi aktet e provat shkresore te çeshtjes :

V E R E N

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka paraqitur para kësaj Gjykate me datë xxx kërkesën kundër shtetasve nën hetim A.Sh. e S.Sh. si dhe personave të tretë C.M. dhe F.Z., me objekt konfiskim pasurie, konkretisht te vlerave perkatese monetare te depozituara prej tyre ne banken perkatese. Gjate gjykimit te çeshtjes jane legjitimuar me cilesine e Personit te Trete ne kuader te ketij hetimi pasurore edhe shtetasit, N.M., N.O., A.H., S.M., Z.Z. dhe S.G.

Ne perfudim te gjykimit, me vendimin nr.xx, date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane, eshte vendosur;

- *Pranimin e kërkesës, konfiskimin e pasurive të mëposhtme:*
- *1. Llogarisë bankare në lekë, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh. me gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xxx) xxx (xxx) lekë.*
- *2. Llogarisë bankare në dollarë amerikanë, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh., me depozitim fillestar xxx (xxx) dollarë amerikanë dhe gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xxx) xxx (xxx) dollarë amerikanë.*
- *3. Llogarisë bankare në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh., me gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xxx) xxx (xxx) euro.*
- *4. Llogarisë në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh., me gjendje në momentin e verifikimit (datë xxx), xxx (xxx) euro dhe, gjendje aktuale xxx (xxx) euro.*
- *5. Llogarisë bankare në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, në emër të A.Sh., me numur bazë të klientit xxx dhe numur depozite me afat xxx, me gjendje në momentin e verifikimit (datë xxx), xxx (xxx) euro dhe gjendje aktuale xxx (xxx) euro.*
- *6. Llogarisë bankare në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të S.Sh. dhe F.Z., në shumën prej xxx (xxx) euro, me gjendje aktuale në momentin e verifikimit (datë xxx), xxx (xxx) euro.*
- *7. Llogarisë bankare në euro, në Banken xxx, Dega, xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të C.M., me një transaksion të vetëm, po në këtë datë, në shumën xxx (xxx) euro.*
- *Për administrimin e përdorimin e pasurive të konfiskuara dhe, ekzekutimin e vendimit ngarkohen Zyrat e Përmbarimit Gjyqësor në xxx dhe xxx dhe administrator A.H., në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.*

- *Shpenzimet procedurale të kryera në shumën 952.776 (nëntëqind e pesëdhjetë e dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë si dhe, shpenzimet gjyqësore u ngarkohen personave nën hetim A.Sh. dhe S.Sh. si dhe, personave të tretë C.M., F.Z., S.G., N.M., S.M., N.O., A.H. dhe Z.Z.*

Mbi ankimin e paleve çeshtja ka shkuar per gjykim ne shkalle te dyte ku, **me vendimin nr.xx, date xxx te Gjykates se Apelit Per Krime te Renda Tirane, eshte vendosur;**

Lenjen ne fuqi te vendimit nr.xx, date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane si dhe referuar nenit 5 pika 3 e Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, urdherohet pezullimi i pasojave te zbatimit te mases se konfiskimit sipas ketij Ligji deri ne dhenjen e vendimit gjyqesor penal.

Mbi rekursin e paraqitur, **Kolegji Penal i Gjykates se Larte me vendimin nr.xxx, date xxx, ka vendosur mospranimin e rekursit** te paraqitur ndaj vendimit nr. xx, date xxx te Gjykates se Apelit Per Krime te Renda Tirane.

Nderkohe qe prane kesaj Gjykate gjykohej kerkesa e Prokurorise Per Krime te Renda me objekt konfiskimin e ketyre pasurive, ne Gjykaten e Rrethit Gjyqësore Tirane, shtetasit A.Sh., S.Sh., C.M. e F.Z., kishin cilesine e te pandehurit te akuzuar per kryerjen e vepres penale, “*Pastrimi i produkteve te vepres penale*”, parashikuar si krim nga neni 287-25 te Kodit Penal.

Ne perfundim te gjykimit, me vendimin penal nr.xxx, date xxx, Gjykata e Rrethit Gjyqësore xxx ka vendosur, deklarimin e pafajshem per te kater te pandehurit, A.Sh., S.Sh., C.M. e F.Z., per vepren penale qe akuzoheshin sipas nenit 388/1/b te Kodit te Procedures Penale, duke argumentuar se fakti nuk perben veper penale. Njekohesisht eshte urdheruar heqja e sekuestros preventive mbi pasurit e sekuestruara sipas neneve 274 e 275 te Kodit te Procedures Penale.

Pasi ky vendim ka mare forme te prere me date xxx pasi ndaj tij nuk eshte ushtruar ankim nga prokurori, me date xxx, **nga shtetasit S.Sh. e A.Sh. eshte paraqitur ne Gjykaten e Larte kerkesa me objekt Rishikimin e vendimit nr.xx, date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane, Rishikimin e vendimit nr.xx, date xxx te Gjykates se Apelit Per Krime te Renda Tirane si dhe Rishikimin e vendimit nr.xxx te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte,** duke argumentuar se prove e re per pranimin e kesaj kerkesa eshte vendimin penal nr.xxx, date xxx i Gjykata se Rrethit Gjyqësore xxx, tashme i formes se prere.

Me vendimin nr.xxx, date xxx Kolegji Penal i Gjykates se Larte Ka

vendosur; pranimin e kerkeses per rishikim dhe per pasoje, prishjen e vendimit nr.xx, date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane, vendimit nr.xx, date xxx te Gjykates se Apelit Per Krime te Renda Tirane si dhe vendimit nr.xxx te Kolegjit Penal te Gjykates se Larte dhe dergimin e çeshtjes per rigjykim ne Gjykatën e Shkalles se Pare Per Krimet e Renda Tirane, me tjeter trup gjykues.

Gjate ketij gjykimi te rishikimit, fillimisht gjykata gjen me vend te shprehet ne lidhje edhe me proceduren ligjore qe ndjek kjo gjykate gjate ketij gjykimi dhe me pas, ne lidhje me themelin e kerkeses per rishikimin e vendimit penal objekt gjykimi.

Ne nenin 5/2 te Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”,* ligjvenesit është shprehur; *“2.Verifikimet, hetimet dhe gjykimi, sipas ketij ligji, mbeshteten ne rregullat procedurale te ketij ligji dhe plotesohen nga rregulla te percaktuara ne Kodin e Procedures Civile.”.*

Ne shqyrtimin e kerkeses me objekt rishikimin e vendimeve sa siper cituam, nga ana e Kolegjit Penal te Gjykates se Larte është referuar procedura ne Kodin e Procedures Penale, konkretisht ne nenin 450, 453 etj. te ketij Kodi.

Gjykata, ne kete konteks, çmon te theksoj faktin se prova (*vendimi penal i gjykates se rrethit gjyqesor Tirane*) qe ka sherbyer per rishikimin ne funksion te ketij gjykimi është marrur nga Gjykata e Larte konform nenit 453 te K.Pr.Penale dhe nuk mund te vihet ne diskutim ne aspektin formal te se drejtes por është e detyrueshme per kete gjykate qe ajo ti nenshtrohet hetimit gjyqesor dhe me pas vlersimit se bashku me rivlersimin e provave te perdorura ne gjykimin e meparshem. **Konkluzionet e Gjykates se Larte ne çeshtjen konkrete jane te detyrueshme per gjykatën e rigjykimit per çdo çeshtje te se drejtes qe është vendosur me te.**

Duke iu referuar Vendimit Unifikues te Kolegjeve te Bashkuara te Gjykates se Larte, nr.3, date 08.07.2013 i cili ka njësuar praktikën gjyqësore per gjykimin e rishikimit, rezulton se vete ky gjykim konsiston ne nje procedur te shkurtuar ne kuptim te respektimit te dispozitave te gjykimit ne shkalle te pare. Sipas keti vendimi, ky gjykim është i nje procedure te veçante. Nder te tjera gjykata ne kete vendim është shprehur; *“...Veçoria e keti gjykimi qendron ne marrjen e atyre provave te cilat kane sherbyer si shkak per rishikimin e vendimit. Kolegjet e Bashkuara te Gjykates se Larte çmojne se gjykata qe rishikon çeshtjen është e detyruar te marre ne rivlersim provat te cilat kane sherbyer ne dhenjen e vendimit pa ju futur dhe nje here shqyrtimit te tyre dhe duke e perqendruar hetimin gjyqesor vetem ne ato prova te cilat kane sherbyer si objekt i kerkeses per rishikim e qe jane perdorur si shkak per pranimin e rishikimit...”.*

Ne rastin objekt gjykimi, sikunder ne çeshtje te tjera gjate gjykimit te rishikimit, mungon faza e marrjes se provave, debati ne lidhje me to etj. si ne gjykimin e zakonshem por behet vetem rivlersim i provave qe kane sherbyer ne dhenjen e vendimit qe rishikohet se bashku me proven qe ka sherbyer per proceduren e rishikimit. Per kete te fundit, gjykata e shkalles se pare ne rastin konkret, kufizohet vetem per vlersimin e kesaj prove ne raport me rivlersimin e provave te meparshme.

Nga sa me sipër, gjate keti gjykimi te rishikimit konform nenit 455 e vijues te Kodit te Procedures Penale, kjo gjykate pas rivlersimit te provave qe kane sherbyer ne dhenien e vendimit nr.xx, date xxx te Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane, lene ne fuqi me vendimin nr.xx, date xxx te Gjykates se Apelit Per Krime te Renda Tirane se bashku me hetimin e vlersimin e proves se re marre nga Gjykata e Larte, vendimi penal i Gjykates se Rrethit Gjyqesore xxx me nr.xxx, date xxx, arrin ne konkluzionin se gjenden te provuara gjate ketij gjykimi keto rrethana e fakte sa vijon;

Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me date xxx, ka rregjistruar procedimin pasuror në ngarkim të shtetasve A.Sh. dhe S.Sh., si të dyshuar për kryerje të veprës penale “*Pastrimi i produkteve të veprës penale*”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, iniciuar nga procedimi penal Nr.xxx/xxx, të rregjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor xxx. Ne vijim, nga prokuroria per krime te renda Tirane, para kësaj gjykate, me datë xxx, eshte depozituar per kompetence gjykimi kërkesa kundër shtetasve nën hetim A.Sh. e S.Sh. si dhe personave të tretë C.M. dhe F.Z., me objekt konfiskim pasurie, konkretisht te vlerave perkatese monetare te depozituara prej tyre ne banken perkatese. Gjate gjykimit te çeshtjes jane legjitimuar me cilesine e Personit te Trete ne kuader te ketij hetimi pasurore edhe shtetasit, N.M., N.O., A.H., S.M., Z.Z. dhe S.G.

Rezulton se nga autoritetet gjyqesore te shtetit Grek jane percjelle autoriteteve perkates Shqipetare akte procedurale penale qe kane pasqyruar faktin se shtetasi A.Sh. dhe vëllai i tij, S.Sh., që nga viti xxx po hetohen në shtetin grek për kryerje të veprave penale “*Krijimi i organizatës kriminale*”, “*Trafikimi i qënieve njerëzore me qëllim ushtrimin e prostitucionit*” dhe “*Pastrimi i parave*”.

Duke i konsideruar shtetasit A.Sh. dhe S.Sh. si subjekte të Ligjit Nr.10192 datë 03.12.2009 “*Për Parandalimin dhe Goditjen e Krimin të Organizuar dhe Trafikimit nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë*”, sipas nenit 3 pika 1 gërma “d”, organi i prokurorisë, bazuar në nenet 3 pika 2 gërma “a”; 6, 8 dhe 9 të Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimin të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, ka kryer veprime hetimore në lidhje me zbulimin, identifikimin dhe verifikimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme, aktiviteteve ekonomike të këtyre shtetasve dhe personave të lidhur me ta. Kështu rezulton se shtetasit te cilet

ishin nën hetim pasuror A.Sh. dhe S.Sh., janë vellezer me njeri tjetrin dhe banorë të fshatit xxx te rrethit xxx. Personi i tretë C.M. është kunati i shtetasve nën hetim, bashkëshorti i motrës së tyre dhe banon në xxx.

Personi tjetër i tretë F.Z. është banor i fshatit xxx, bashkëfshatar dhe lidhje shoqërore e shtetasve nën hetim, vëllezërve Sh.

Nga aktet e provat e shqyrtuara në gjykimet e mëparshme, rezulton se A.Sh. është mbajtës i gjashtë llogarive bankare, të çelura në Bankën xxx, Dega xxx, në lekë, në dollarë amerikanë dhe në euro, konkretisht, Llogarisë bankare në lekë, me Nr. xxx, të çelur në datë xxx me gjendje faktike, në datën e verifikimit xxx, xxx lekë. Llogarisë bankare në dollarë amerikanë, me Nr. xxx, të çelur në datë xxx, me depozitë fillestare xxx (xxx) dollarë dhe gjendje faktike në datën e verifikimit xxx, xxx (xxx) dollarë. Në këtë llogari nuk kanë rezultuar të kryera veprime të tjera. Llogarisë në euro, me Nr. xxx, të çelur në datë xxx, në shumën xxx (xxx) euro. Transaksioni i fundit në këtë llogari ka rezultuar i kryer në datë xxx, në shumën xxx (xxx) euro. Ky transaksion ka shërbyer për të çelur, në datë xxx, një llogari tjetër në euro. Gjendja e saj në datën e verifikimit, xxx, ka rezultuar zero. Llogarisë në euro, me Nr. xxx, të çelur në datë xxx, në shumën xxx (xxx) euro. Në këtë depozitë kanë rezultuar të kryera veprime financiare, kryesisht depozitime në kesh, transferime të vlerave monetare në drejtim të Greqisë, kalime në llogari bankare me afat maturimi njëvjeçar. Gjendja e llogarisë në momentin e verifikimit, datë xxx, ka rezultuar xxx (xxx) euro. Llogarisë në euro, me Nr. xxx, të çelur në datë xxx, në shumën xxx (xxx) euro, shumë e cila është tërhequr nga njëra prej llogarive në euro të lartpërmendura. Në këtë depozitë janë kryer dy veprime financiare. Njëri prej tyre ka të bëjë me një depozitim në kesh të një shume prej x(xx) xxx euro, kryer në datë xxx, me një afat maturimi x vjeçar. Për këtë transaksion, si burim për shumën xxx (xxx) euro shtetasi A.Sh. ka deklaruar një hua të marrë nga kunati i tij, personi i tretë, C.M. duke paraqitur, në vërtetim të këtij pretendimi, Kontratën e Huasë, datë xxx me afat shlyerje një vit. Në datë xxx, mbi kërkesën e shtetasit A.Sh. është kryer veprimi i transferimit, nga llogaria e tij në drejtim të llogarisë së shtetasit C.M., të shumës prej xxx euro me emërtimin “kthim borxhi”. Gjendja e kësaj llogarie në datë xxx, ka qënë në shumën xxx (xxx) euro dhe, në momentin e bllokimit xxx (xxx) euro. Llogarisë në euro, me numur bazë të klientit xxx dhe numur depozite me afat xxx, të çelur pranë Bankës xxx, Dega xxx, në datë xxx, në shumën rreth xxx (xxx) euro. Gjendja e saj, në momentin e identifikimit, në datë xxx, ka qënë afërsisht xxx (xxx (xxx) euro. Shtetasi S.Sh. ka çelur, në datë xxx, në Bankën xxx, Dega xxx, një llogari bankare në euro, me Nr. xxx, në shumën prej xxx (xxx) euro. Kjo shumë është vendosur në depozitë një vjeçare e cila, pas maturimit, në datë xxx është vendosur sërish në depozitë një vjeçare me afat maturimi në datë xxx. Në momentin e çeljes së llogarisë, shtetasi S.Sh. ka deklaruar si burim të ardhurash aktivitetin e tij tregëtar. Kjo llogari bankare ka si mbajtës të parë shtetasin nën hetim S.Sh. dhe, si mbajtës të dytë personin e

tretë F.Z. Gjendja e kësaj llogarie në momentin e verifikimit ka qënë xxx (xxx) euro.

Shtetasi C.M., ka rezultuar mbajtës i dy llogarive bankare në euro.

Llogaria bankare me Nr. xxx, ka rezultuar e çelur në datë xxx, në Bankën xxx, Dega xxx, me një transaksion të vetëm, të kryer po në këtë datë, në shumën xxx euro, me burim të deklaruar, kthimin e borxhit nga shtetasi A.Sh. Llogaria bankare në Bankën xxx Dega xxx, me Nr. xxx, ka rezultuar e çelur në datë xxx. Në këtë llogari janë kryer disa transaksione, depozitime dhe, më pas transferime, në shuma prej xxx (xxx) euro, në drejtim të disa shtetaseve të huaja, femra, në qytetin xxx, xxx. Gjithashtu, në këtë llogari, në datë xxx është transferuar, nga Av. Sh.D., shuma prej xxx (xxx) euro, nën emërtimin “Kapar për blerjen e një toke dhe karburanti në autostradë, km.11”, ndodhur në fshatin xxx,xxx, xxx. Toka dhe karburanti kanë rezultuar në pronësi të shtetasit A.Sh. Gjendja e llogarisë në momentin e identifikimit ka qënë në shumën prej (xxx) euro.

Edhe shtetasi F.Z. rezulton te posedonte vlera monetare te depozituara ne banke. Sipas aktee perkatese rezulton se shtetasi F.Sh.Z. ka patur pranë Bankës xxx, deri në datë xxx, llogarinë me Nr. xxx, numur i cili, me ndryshimin e sistemit të bankës, që nga data xxx është xxx. Në këtë llogari shtetasi F.Z., në datë xxx ka depozituar shumën prej xxx euro, të cilën e ka vendosur në depozitë me afat 3 mujor, ndërkohë që në datë xxx, ka depozituar shumën prej xxx (xxx) euro, të cilën, në po të njëjtën datë, e ka vendosur në depozitë me afat 1 vjeçar.

Pas kryerjes se procedurave investigative ne kuadër të hetimit pasuror kundrejt aktivitetit ekonomike dhe tregëtare të shtetasve nën hetim A. e S.Sh. si dhe, personave të tretë C.M. e F.Z., arrihet ne perfundimin se keta shtetas kishin kryer aktivitet ekonomik edhe ne vendin tone ne fusha te ndryshme, aktivitete te cilat duke u pare ne analize e vlersim te te gjitha provave perkatese kane rezultuar me bilance jo pozitive dhe per me teper jane ndermare kryesishte per te justifikuar vlerat e medha monetare te cilat ata i dispononin dhe i kishin depozituar ne banke. Keshtu, shtetasi A.Sh. ka rezultuar ortak dhe administrator i vetëm i Shoqërisë “xxx”, SH.P.K. Kjo shoqëri është rregjistruar në datë xxx, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor xxx dhe është subjekt tatimor i Degës së Tatimeve xxx, me numur NIPTI xxx. Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është tregëtia me pakicë dhe shumicë e karburanteve, bar-kafe, import dhe eksport mallrash të ndryshëm. Nga të dhënat, kryesisht bilancet e dorëzuara, ka rezultuar se ky aktivitet është deklaruar me humbje. Për të ushtruar këtë aktivitet ky shtetas ka blerë, në datë xxx një sipërfaqe toke prej xxx (xxx) m², në fshatin xxx, xxx, xxx dhe karburanti, që ndodhet aktualisht në të, ka Siglën e Shoqërisë

“xxx”. Shtetasi S.Sh. ka rezultuar i rregjistruar, në datë xxx, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor xxx si person fizik, për ushtrimin e aktivitetit ekonomik të tregëtimit me pakicë të karburanteve. Ky shtetas është rregjistruar edhe si subjekt tatimor në Zyrën e Tatim-Taksave, në Komunën xxx, rrethi xxx, me numur NIPTI xxx. Ky aktivitet ka rezultuar i mbyllur në datë xxx. Ushtrimi i këtij aktiviteti është kryer mbi një sipërfaqe toke, të rregjistruar në emër të shtetasit A.Sh., babai i vëllezërve Sh. Shtetasi C.M. ka rezultuar i rregjistruar si subjekt tatimor i Degës së Tatimeve xxx, në fushën e “Shërbimeve telefonike”, në datë xxx, me numur NIPTI xxx. Nga të dhënat e marra në rrugë zyrtare, ka rezultuar se ky subjekt është vetëdeklaruar biznes i vogël. Edhe ky aktivitet ka rezultuar i mbyllur.

Po kështu shtetasi F.Z., me cilesine e personit te trete, ka rezultuar i rregjistruar në Degën e Tatimeve xxx, si subjekt tatimor me numur NIPTI xxx, ku si veprimtari kishte ushtrimin e aktivitetit në fushën e serave, për mbjellje perimesh dhe dru-frutorësh.

Edhe ne procesin gjyqësor te meparshem, ne perfundim te gjykimit mbi kerkesen per sekuestrim dhe me pas konfiskimin e pasurise se sipercituar, nga ana e kesaj gjykate eshte konkluduar se personat posedues te ketyre pasurive, megjithse u ishte dhene gjithe mundesia kohore e procedurale ligjore nuk kishin arritur te justifikonin keto pasuri dhe te provonin se ato kishin perjardhje te ligjshme. Perkundrazi, referuar provave perkatese ka rezultuar gjate hetimit pasuror se poseduesit e ketyre pasurive, kishin qene dhe vazhdonin te ishin permanent ne perpjekjen e tyre per te justifikuar shumat e medha te vlerave monetare me veprime ekonomike jo rentabel dhe jo fitimpruese, jo vetem ne raport me keto vlera por edhe me vlera disa here me te vogla se ato. Per pasoje eshte disponuar ne perfundim me vendosjen e konfiskimit te shumave perkatese monetare. Sikunder u citua, gjykata e Apelit Per Krime te Renda ka lene ne fuqi vendimin e gjykates se Shkalles se Pare dhe Kolegji Penal i Gjykates se Larte ka vendosur mospranimin e rekursit te ushtruar nga personat nen hetim A.Sh. e S.Sh. si dhe Personat e Trete.

Personat nen hetim pasuror, A.Sh. e S.Sh. si dhe personat të tretë C.M., F.Z., N.M., N.O., A.H., S.M., Z.Z. dhe S.G., u eshte dhene mundesia gjate gjykimit te meparshem si subjekte te hetimit pasurore qe te justifikojne pasurin e cila me pas u eshte konfiskuar. Ashtu sikunder edhe gjate ketij gjykimi, as ne gjykimet e meparshme nuk eshte arritur qe te justifikohet asnje nga vlerat monetare te cilat jane konfiskuar, perkundrazi ekzistojne prova te cilat pare ne kendveshtrimin e indicjeve, jane te sakta e ne perputhje me njera tjetren duke sjellur njohje mbi

faktin se keta shtetas mundohen te argumentojne gjendjen e pa justifikuar te ketyre pasurive me veprime fiktive, jo bindese dhe kontradiktore ne vete permbajtjen e tyre.

Ndryshe nga sa pretendohet nga pala kerkuese si dhe prokurori ne çeshtjen objekt i ketij gjykimi, vendimi penal i gjykates se rrethit gjyqesor xxx ka patur objekt shqyrtimi nje pjese te veprimtarise kriminale te shtetasve S.Sh. e A.Sh., konkretisht faktet penale te pretenduara nga akuza se kane ndodhur ne teritorin e shtetit Shqiptar dhe qe lidhen me vepren penale *“Pastrimi i produkteve te vepres penale”*, parashikuar si krim nga neni 287-25 te Kodit Penal. Keta shtetas, sipas akteve perkatese te derguara nga autoritetet gjyqesore te shtetit xxx ne formen e kerkuar nga ligji dhe te pranuar proceduralisht nga autoritetet Shqiptare, rezulton se jane ne hetim(*se paku ne hetim*) ne shtetin xxx edhe per aktivitet kriminal me nje rrezikshmeri shume me te madhe shoqerore, se vepra penale e parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. Autoritetet xxx kanë informuar se shtetasi A.Sh. dhe vëllai i tij, S.Sh., që nga viti xxx po hetohen në shtetin xxx për kryerje të veprave penale *“Krijimi i organizatës kriminale”*, *“Trafikimi i qënieve njerëzore me qëllim ushtrimin e prostitucionit”* dhe *“Pastrimi i parave”*, te cilat parashikohen si vepra penale ne nenin 3 te Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*.

Ne interpretim te Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, qellimi i ligjvenesit ka qene pikerisht qe te vendoset masa e konfiskimit ndaj pasurive qe nuk mund te konfiskohen sipas Kodit te Procedures Penale gjate nje procesi gjyqesor penal kur poseduesit apo pronaret e tyre nuk arrijne te justifikojne prejardhjen e ligjshme te tyre. Pra mjaft qe njeri prej zoteruesve te ketyre pasurive apo personat e lidhur me te, te jene nen nje dyshim te arsyeshem, bazuar ne indicje, per pjesmarje ne aktivitet kriminal per nje nga veprat penale te percaktuar ne nenin 3 te ketij Ligji dhe ai ka barren e proves per te provuar ligjshmerine e prones. Nderkohe ne procesin penal kjo barre i perket prokurorit. Edhe si ne rastin konkret, kur vlerat monetare jane plotesisht te pa justifikuara, sikunder pershkruhet gjate gjykimit ne gjykatën e rrethit gjyqesor xxx, ato nuk mund ti nenshtrohen konfiskimit pasi duhet te provohet qe jane produkt, etj. i drejtperdrejte i nje vepre penale konkrete qe lidhet me faktin penal konkret objekt i atij gjykimi.

Ne kete kendveshtrim ligjore, vendimi penal i gjykates se rrethit gjyqesor xxx nuk ka asnje kundershiti me faktet e rrethanat e konkluduara si te provuara gjate hetimit pasurore. Ne te kundert me karakterin qe ka konfiskimi tek parashikimet e Kodit te Procedures Penale si mase denimi penal, konfiskimi tek Ligji nr.10192, datë 03.12.2009, ka karakter parandalues dhe aplikohet ndaj

personave mbi te cilet ekzistojne thjeshte dyshime per perfshirjen ne kryerjen e nje numri te kufizuar veprash penale pa patur nevojte apo detyrim qe te provohet pjesmarrja e tyre ne kete aktivitet kriminal tej çdo dyshimi te arsyeshem apo pa qene e nevojshme qe te provohet se cila ka qene pikerisht vepra penale konkrete qe ka passellur krijimin e kesaj pasurie.

Ne nenin 6 te Kodit Penal nder te tjera ligjvenesit shprehet *“Ligji penal i Republikes se Shqiperise eshte i zbatueshem edhe per shtetasin shqiptar qe kryen krim ne territorin e nje shteti tjetër, kur krimi eshte njekohesisht i denueshem dhe derisa nuk eshte dhene per te nje vendim perfundimtar nga nje gjykate e huaj.”*. Shtetasit Sh., jane te dyshuar dhe vazhdojne te mbeten potencialisht te mundshem, referuar akteve te percilla nga autoritetet greke, si pjesmarres ne kryerjen e veprave penale, *“Krijimi i organizatës kriminale”* dhe *“Trafikimi i qënieve njerëzore me qëllim ushtrimin e prostitucionit”*, te cilat parashikohen si vepra penale me nje rrezikshmeri te madhe shoqerore edhe nga kodi yne penal(*neni 333 KP etj.*) dhe jane te perfshira ne nenin 3 te Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009.

Fakti qe sipas vendimit penal te gjykates se rrethit gjyqesor xxx nuk provohet qe keto vlera monetare te dyshuara te kene lidhje me veprat penale per te cilat ata jane deklaruar te pafajshem nga ajo gjykate, nuk passjell pamundesine e konfiskimit te ketyre vlerave monetare per sa kohe ata apo personat e lidhur me ta nuk arriten as gjate ketij gjykimi dhe as gjate gjykimit te meparshem qe te justifikojne prejardhjen e ligjshme te ketyre pasurive.

Ne bisedimet perfundimtare te prokurorit referohet ne pjesen pershkruese arsyetuese te vendimit penal nr.xxx, date xxx, sipas te cilit *fakti i pretenduar si fakt kriminal nuk perben veper penale... Gjithashtu nuk u provua se te pandehurit kane vepruar ne bashkepunim me njeri tjetrin per te kryer veper penale. Pra Gjykata konfirmon se nuk ekzistojne veprat penale per te cilat interpol xxx ka informuar autoritetet shqiptare.* Nje qendrim i tille i prokurorit eshte i gabuar pasi ne vendimin gjyqesor qe referon nuk ka qene objekt gjykimi e per pasoje as i shqyrtimit gjyqesor gjithë veprimtaria kriminale e te dyshuarve Sh. si, *“Krijimi i organizatës kriminale”* dhe *“Trafikimi i qënieve njerëzore me qëllim ushtrimin e prostitucionit”*, te cilat parashikohen si vepra penale me nje rrezikshmeri te madhe shoqerore edhe nga kodi yne penal(*neni 333 KP etj.*) si dhe, jane te perfshira ne nenin 3 te Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, por vetem per vepren penale te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Po keshtu, eshte i gabuar edhe pretendimi se shtetasit S. e A.Sh. kane vazhduar me aktivite te ligjshme edhe pasi veprimtaria e tyre sipas informacionit te

interpolit ka qene objekt hetimi. Sipas Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009, nuk eshte e nevojshme te provohet tej çdo dyshimi te arsyeshem se pasuria e personave te dyshuar per nje rreth te caktuar veprash penale eshte pasoje e nje aktiviteti konkret kriminal. Ndryshe nga çeshtja penale ku duhet te provohet me prova tej çdo dyshimi te arsyeshem se pasuria eshte rrjedhoje e nje aktiviteti konkret kriminal, per vepren penale konkrete dhe te provohet lidhja shkak pasoje, duke patur prokurori barren e proves per te provuar faktet e rrethanat konkrete, ne ligjin qe normon hetimin pasuror nuk kerkohet nje standart i tille provash. Pasuria ne te kundert me sa ndodh ne nje proces penal, mund te konfiskohet edhe nese lidhja e personit nen hetim me aktivitetin kriminal eshte e dyshimte. Sipas nenit 4 te K.Pr.Penale çdo dyshim per akuzen çmohet ne favor te te pandehurit. Nderkohe qe gjate hetimit pasurore sipa Ligjit, perkundrazi keto dyshime te mbeshtetura edhe ne indicje jo vetem qe nuk jane ne favor te personit nen hetim por perkundrazi mjaftojne qe ketij te fundit ti kaloje barra e proves per te provuar tej çdo dyshimi te arsyeshem se pasuria eshte perfituar, siguruar ne nje nga format qe parashikon ligji.

Ne perfundim, nga vlersimi i proves se re*(vendimi penal i gjykates se rrethit gjyqesor Tirane, me nr.821, date 23.05.2012)* **e cila ka sherbyer per pranimin e kerkeses per rishikim, rezulton se perveç sa tham me siper, nuk sjell asnje njohje te faktit nese personat te cileve u eshte konfiskuar pasuria e kane siguruar ate ne rruge te ligjshme.**

Referenca qe prokurori dhe mbrojtja bejne ne nenin 24 te Ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*, nuk duhet te interpretohet i shkeputur nga neni 5/1 dhe 21/3 te ketij ligji.

Ne nenin 5/1 te Ligjit parashikohet se *“Procedura e caktimit dhe e zbatimit te masave parandaluese, sipas ketij ligji, eshte autonome nga gjendja, shkalla apo perfundimi i procedimit penal qe zhvillohet ne ngarkim te personave, subjekte te ketij ligji”*.

Ndersa ne 21/3 te po keti ligji parashikohet se; *“Barra e proves, per te vertetuar se pasurite jane fituar ne menyre te ligjshme, i perket personit, kunder pasurive te te cilit kerkohet konfiskimi”*.

Ne rastin konkret kerkuesit si dhe personat e lidhur me ta sipas nenit 3/2 te Ligjit, kane qene subjekt te ketij ligji, ka patur indicje dhe vazhdon te kete te tilla qe implikojne dhe mbeshtetin dyshimin se personat nen hetim jane te perfshire ne veprimtari kriminale per vepra penale te parashikuara nga neni 3/1 i ketij ligji. Gjithashtu, me provat e paraqitura dhe të marra në gjykim, shtetasit nën hetim

dhe personat e tretë nuk arritën të provonin prejardhjen e ligjshme të pasurive objekt konfiskimi apo, të justifikonin zoterimin e shumave të pretenduara si të dhëna borxh apo hua.

Ne kete kendveshtrim ligjore, vendimi penal i gjykates se rrethit gjyqesor Tirane nuk ka asnje kundershiti me faktet e rrethanat e konkluduara si te provuara gjate hetimit pasurore. Per rrjedhoje, kjo gjykat, ne zbatim te nenit 456/2 te K.Pr.Penale, nuk mund te marre nje vendim tjetër te ndryshem nga vendimi qe rishikohet, bazuar ne nje vlersim tjetër te provave te marra ne gjykimin e meparshem.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata bazuar ne nenet 455 e vijues te K.Pr.Penale si dhe, në nenet 3, 7, 21, 22, 23, 24 e vijues të ligjit nr.10192, datë 03.12.2009 *“Për parandalimin dhe Goditjen e Krimit të Organizuar dhe Trafikimit Nëpërmjet Masave Parandaluese kundër Pasurisë”*;

V E N D O S I:

I. Konfirmimin e vendimit nr.14, date 14.12.2011 te Gjykates se Shkalles se Pare Per Krime te Renda Tirane, duke vendosur konfiskimin e pasurive të mëposhtme;

- 1.** Llogarisë bankare në lekë, në Bankën xxx, Dega Tiranë, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh. me gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë (xxx) xxx (xxx) lekë.
- 2.** Llogarisë bankare në dollarë amerikanë, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh., me depozitim fillestar xxx (xxx) dollarë amerikanë dhe gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xxx) xxx (xxx) dollarë amerikanë.
- 3.** Llogarisë bankare në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr.xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh., me gjendje aktuale (në momentin e verifikimit, datë xxx) xxx (xxx) euro.
- 4.** Llogarisë në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të A.Sh., me gjendje në momentin e verifikimit (datë xxx), xxx (xxx) euro dhe, gjendje aktuale xxx (xxx) euro.
- 5.** Llogarisë bankare në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, në emër të A.Sh., me numur bazë të klientit xxx dhe numur depozite me afat

xxx, me gjendje në momentin e verifikimit (datë xxx), xxx (xxx) euro dhe gjendje aktuale xxx (xxx) euro.

6. Llogarisë bankare në euro, në Bankën xxx, Dega xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të S.Sh. dhe F.Z., në shumën prej xxx (xxx) euro, me gjëndje aktuale në momentin e verifikimit (datë xxx), xxx (xxx) euro.

7. Llogarisë bankare në euro, në Banken xxx, Dega, xxx, me Nr. xxx, e hapur në datë xxx, në emër të C.M., me një transaksion të vetëm, po në këtë datë, në shumën xxx (xxx) euro.

Për administrimin e përdorimin e pasurive të konfiskuara dhe, ekzekutimin e vendimit ngarkohen Zyrat e Përmbartimit Gjyqësor në xxx dhe xxx dhe administrator A.H., në Agjensinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

Shpenzimet procedurale të kryera në shumën 952.776 (nëntëqind e pesëdhjetë e dymijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë si dhe, shpenzimet gjyqësore u ngarkohen personave nën hetim A.Sh. dhe S.Sh. si dhe, personave të tretë C.M., F.Z., S.G., N.M., S.M., N.O., A.H. dhe Z.Z.

II. Shpenzimet gjyqësore ne masen e bere gjate ketij gjykimi i ngarkohen pales kerkuese.

Kunder këtij vendimi lejohet ankim brenda afatit ligjore pesëmbëdhjetë dite ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda Tirane, duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes ketij vendimi.

U shpall ne Tirane sot me date 10.12.2014

SEKRETARE
Ermira TERBUNI

GJYQTAR
Fran PRENDI